



# Ngërçet e etheve

## Çka janë ngërçet e etheve?

- Ngërçet e etheve janë sulme, të cilat shkaktohen nga ethet.
- Përafërsisht 3 prej 100 fëmijëve e përjetojnë një sulm të tillë.
- Rastet familjare janë të njohura
- Të prekur janë fëmijët në mes të muajit të 6 të jetës dhe vitit të 6.
- Ngërçi i etheve paraqitet papritmas dhe shpesh pranë ngritjes së 1. Të etheve, por mundet të paraqitet çdo kohë gjatë etheve.
- Fëmijët alivanosen, shtangohen dhe kanë dridhje ritmike në tërë trupin. Gjatë kësaj sytë janë të hapur dhe të kthyer së larti. Ngjyra e fytyrës mund të jetë e kaltër, kuqe apo zbehët. Shpesh këto sulme zgjasin më pak se 5 minutë. Pas sulmit, fëmijët janë të përgjumur.
- Për ngërçe të etheve të komplikuara bëhet fjalë, kur sulmi zgjatë më

tepër se 15 minuta apo ndodh disa herë brenda 24 orëve apo e prekë vetëm një gjysmë të trupit gjegj. pas sulmit përkohësisht mbetet gjysma e trupit e paralizuar.

- Ngërçi i etheve nuk është epilepsi!

## Çfarë rreziqe fshehën pas ngërçit të etheve?

- Raste të vdekjes prej ngërçit të etheve nuk janë të njohura.
- Në rast sulmi, shumë rrallë vjen deri te lëndimet apo gëlltitja e ushqimit.
- Ngërçet e etheve nuk kanë pasoja për zhvillim neurologjik apo shpirtëror.
- Rreziku për një epilepsi të më vonshme është i ulët.
- Pasi që pas etheve mund të fshihet një sëmundje serioze, ju do të duhej që pas ngërçeve të etheve gjithmonë të e vizitoni mjekun.

## Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni me pagesë për këshillime: 0900 266 71 1

---

### A mund të përsëritet një ngërç i etheve?

- Shumica e fëmijëve e përjetojnë vetëm një ngërç të etheve.
- Rreth 30% e kanë një ngërç të dytë të etheve, rreth 10% tre dhe më tepër ngërçe etesh.

### Çka mund të bëhet për evitimin e një ngërçi të etheve?

- Nuk ekzistojnë masa të cilat e ndalojnë ngërçin e etheve.
- Një trajtim i vazhdueshëm me Antiepileptik nuk bëhet për shkak të efekteve anësore dhe prognozës së mire për ngërçe të etheve.
- Veprimi profilaktik i masave të uljes së etheve nuk është vërtetuar.

### Çka duhet të bëjë në rast të ngërçeve të etheve?

1. Ruajeni qetësinë! Një ngërç etesh është i pa rrezikshëm, edhe pse nuk duket ashtu.
2. Largoni gjësendet, me të cilat fëmija juaj do të mund të lëndohet.
3. Shikoni në orë, për ta vlerësuar kohë zgjatjen e sulmit.
4. Nëse sulmi zgjatë mbi 5 minuta jepini Diazepam Rektiolen 5 mg (nën 1 vjeç) apo 10 mg (mbi 1 vjeç) në After.
5. Nëse sulmi nuk ndalon pas 10 minutave, thirrreni mjekun emergjent (Tel. 144)
6. Pasi që disa Fëmijë pas sulmit vjellin, ju do të duhej fëmijën të e vendosni në pozitë anësore pas sulmit.

**Assesi nuk guxoni fëmijën tuaj të e tundni, shtrëngoni, provoni të e hapni nofullën me force, vendosni gjë në mes të dhëmbëve, i jepni frymë gojë në gojë (fëmijët gjatë sulmit shpesh janë të mavijosur) apo spërkatni me ujë.**